

FOL

RAPORTI MBI MONITORIMIN E PUBLIKIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE



JANAR – DHJETOR 2022



**RAPORTI MBI
MONITORIMIN
E PUBLIKIMIT
TË VENDIMEVE
GJYQËSORE**

JANAR – DHJETOR 2022

Titulli: **Raporti mbi monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore (janar – dhjetor 2022)**

Autore: **Lëvizja FOL**

Monitorues: **Valdrin Berbatovci, Deona Kamberaj, Leunora Azemi dhe Viona Bunjaku**

Viti i botimit: **Mars 2023**

Publikuar nga: **Lëvizja FOL**

Andrea Gropa nr.35
Prishtina 10000, Republika e Kosovës
info@levizjafol.org
+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2023. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky projekt mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe Sundim të Ligjit (INL). *Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive.....	06
2. Metodologjia	12
3. Baza ligjore e publikimit të aktgjykimeve	14
Gjykata Supreme	16
Gjykata e Apelit	21
Gjykata Komerciale.....	26
Gjykata Themelore e Prishtinës	29
Gjykata Themelore e Mitrovicës.....	34
Gjykata Themelore e Pejës	40
Gjykata Themelore e Prizrenit.....	45
Gjykata Themelore e Ferizajt	51
Gjykata Themelore e Gjilanit.....	56
Gjykata Themelore e Gjakovës	61
Rekomandime	66
Burimet:	67

1. Përmbledhja ekzekutive

Publikimi i vendimeve, përveç që është një obligim ligjor, paraqet edhe një hap të rëndësishëm në respektimin e vlerave të një gjyqësie bashkëkohore e transparente. Rrjedhimisht, me qëllim të përmbushjes së këtij misioni, nga janari i vitit 2019 gjykatat janë të obliguara që brenda 60 ditësh t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre zyrtare të gjitha vendimet, si akte që shënojnë epilogun e një procesi gjyqësor.

Raporti mbi monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore (janar-dhjetor 2022) përmban të dhëna që rrjedhin nga monitorimi sistematik i publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë kësaj periudhe një vjeçare.

Gjetjet kryesore që rrjedhin nga monitorimi i vendimeve janë renditur në tekstin e mëposhtëm.

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës **janë publikuar gjithsej 34,694 vendime**. Gjatë kësaj periudhe janë zgjidhur gjithsej 97,156 lëndë, që nënkupton se janë publikuar rreth 36% e lëndëve të zgjidhura.¹
- Ky nivel i publikimit dëshmon rritje të publikimit prej 41 % në krahasim me vitin 2021, ku në ueb-faqen e KGJK-së ishin publikuar 24,593 vendime.
- Gjykatat me më së shumti vendime të publikuara në proporcion me lëndët e zgjidhura gjatë periudhës përkatëse janë:
 - **Gjykata Supreme**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 4,551 lëndë, ndërsa ka publikuar 3,188 vendime (70 % të lëndëve);
 - **Gjykata e Apelit**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 15,013 lëndë, ndërsa ka publikuar 7,451 vendime (50 % të lëndëve); si dhe
 - **Gjykata Themelore e Ferizajit**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 6,282 lëndë, ndërsa ka publikuar 2,875 vendime (46 % të lëndëve);

¹ Në këto shifra nuk janë përfshirë vendimet e njehta që janë evidentuar gjatë monitorimit si dhe procesverbalet e publikuara nga ana e gjykatave, që gjithsej përbëjnë 482 vendime të tilla.

- Degët e gjykatave me më së shumti vendime të publikuara në proporcion me lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së monitorimit janë:
 - **Dega e Kaçanikut**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 974 lëndë, ndërsa ka publikuar 601 vendime (61 % të lëndëve),
 - **Dega e Rahovecit**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 1,493 lëndë, ndërsa ka publikuar 853 vendime (49 % të lëndëve), si dhe
 - **Dega e Malishevës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 1,067 lëndë, ndërsa ka publikuar 565 vendime (53% të lëndëve).

- Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore të Ferizajt prijnë me numrin e vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe. I pari në renditje qëndron gjyqtari *Mahir Tutuli*, i cili gjatë kësaj periudhe ka publikuar 770 vendime. Më pas renditet gjyqtari *Liridon Maloku*, i cili ka publikuar 639 vendime, si dhe gjyqtari nga Gjykata Themelore e Ferizajt, *Faton Ajvazi*, me 586 vendime të publikuara.

- Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 30% janë vendime të natyrës penale; 54 % janë vendime të natyrës civile; 6 % janë administrative dhe 10 % janë të natyrës ekonomike.

- Gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë publikuar 92 vendime të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe 462 vendime të dhunës në familje.

- Gjykatat të cilat kanë publikuar më së shumti lëndë nga veprat penale të dhunës në familje gjatë kësaj periudhe të monitorimit janë: *Gjykata Themelore e Prizrenit* me 124 vendime, *Gjykata Themelore e Gjakovës* me 72 vendime dhe *Gjykata Themelore e Mitrovicës* me 71 vendime. Ndërsa sa i përket veprave penale të natyrës së korrupsionit, gjykatat me më së shumti lëndë të publikuara të kësaj natyre janë: *Gjykata e Apelit* me 21 lëndë të publikuara; *Gjykata Themelore e Prishtinës* me 15 lëndë të publikuara dhe *Gjykata Themelore e Gjilanit* me 13 lëndë të publikuara.

- Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, zbatimi në përpikmëri i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Vendimeve është evidentuar në 29,572 vendime, apo në 85 % të të gjitha vendimeve të publikuara. Në pjesën tjetër prej 5,122 vendimesh, përkatësisht në 15% të tyre, është vërejtur ngecje në zbatimin e këtij vendimi.

- Gjatë kësaj periudhe, 95% e vendimeve janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa 5% e vendimeve janë publikuar në gjuhën serbe.

- Gjatë vitit 2022 të gjitha gjykatat kanë shënuar rritje të publikimit në raport me vitin 2021, me përjashtim të Gjykatës Themelore të Pejës, e cila gjatë vitit 2022 ka publikuar 24 % më pak aktgjykime.

- Sa i përket anonimizimit të të dhënave personale, gjatë kësaj periudhe të monitorimit gjykatat me më së shumti lëshime në zbatimin e *Udhëzimit Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Vendimeve të Plotëfuqishme* janë: *Gjykata Themelore e Prishtinës* me 304 vendime të paanonimizuara, pastaj *Gjykata Themelore e Gjakovës* me 285 vendime të paanonimizuara, si dhe *Gjykata Themelore e Gjilanit* me 158 vendime të paanonimizuara.

- Gjykatave u janë dashur mesatarisht **79 ditë** për t'i publikuar vendimet në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes së tyre. Kjo mesatare bie ndesh me kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat, ku thuhet "*gjykatat publikojnë të gjitha vendimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi*". Më së shumti kohë në publikimin e vendimeve llogaritur nga dita e nxjerrjes i janë dashur *Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykatës së Apelit, dhe Gjykatës Themelore të Gjilanit*. Ndërsa *Gjykata Themelore e Ferizajt, Gjykata Supreme* dhe ajo e *Gjakovës* këtë afat e kanë respektuar në përpikmëri.

- Ueb-faqja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ende ka probleme të natyrës teknike sa i përket numërimit automatik të aktgjykimeve. Kjo për shkak se, nëse numërohen manualisht në baza mujore të gjitha aktgjykimet e publikuara, numri rezulton të jetë më i lartë, se numri total i aktgjykimeve të numëruara automatikisht nga sistemi i ueb-faqes.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura si dhe të vendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

TABELA 1

Lëndët e zgjidhura dhe vendimet e publikuara nga të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës në ueb-faqen e Keshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykatat e Republikës së Kosovës	Numri i lëndëve të zgjidhura	Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara, e shprehur në përqindje	Numri i aktgjykimeve të publikuara
Gjykata Supreme	4,551	70%	3,188
Gjykata e Apelit	15,013	50%	7,451
Gjykata Komeriale	1,038	40%	422
Gjykata Themelore e Prishtinës	23,580	25%	5,784
Gjykata Themelore e Ferizajt	6,282	46%	2,875
Gjykata Themelore e Mitrovicës	7,271	45%	3,254
Gjykata Themelore e Prizrenit	13,318	22%	3,011
Gjykata Themelore e Gjakovës	8,600	45%	3,305
Gjykata Themelore e Pejës	9,082	18%	1,660
Gjykata Themelore e Gjilanit	8,421	44%	3,744
TOTAL	97,156	36%	34,694

Ndërsa në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin të lëndëve të zgjidhura si dhe të vendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 nga të gjitha degët e Gjykatave të Republikës së Kosovës.

TABELA 2

Lëndët e zgjidhura dhe vendimet e publikuara nga të gjitha degët e Gjykatave të Republikës së Kosovës në ueb-faqen e Keshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykatat themelore	Degët e gjykatave themelore	Numri i lëndëve të zgjidhura	Numri i aktgjykimeve të publikuara	Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara, e shprehur në përqindje
Gjykata Themelore në Prishtinë	Dega në Podujevë	2,648	202	8%
	Dega në Gracanicë	627	1	0.20%
	Dega në Lipjan	2,029	772	38%
	Dega në Glllogoc	1,938	850	44%
Gjykata Themelore në Gjilan	Dega në Kamenicë	1,073	347	32%
	Dega në Viti	1,885	470	25%
	Dega në Novobërdë	504	240	48%
Gjykata Themelore në Prizren	Dega në Suharekë	2,962	540	18%
	Dega në Dragash	559	147	26%
Gjykata Themelore në Mitrovicë	Dega në Leposaviq	236	101	43%
	Dega në Vushtrri	2,708	1,332	49%
	Dega në Zubin Potok	139	39	28%
	Dega në Skenderaj	1,336	432	32%
Gjykata Themelore në Gjakovë	Dega në Malishevë	1,067	565	53%
	Dega në Rahovec	1,493	853	57%
Gjykata Themelore në Pejë	Dega në Istog	1,871	693	37%
	Dega në Klinë	1,176	272	23%
	Dega në Deçan	1,291	268	21%
Gjykata Themelore në Ferizaj	Dega në Kaçanik	974	601	61%
	Dega në Shtërpçë	520	127	24%
TOTAL		27036	8852	33%

Totali i vendimeve gjyqësore të publikuara nga Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022



2. Metodologjia

Lëvizja FOL për përpilimin e të dhënave të këtij raporti ka përdorur metodën e monitorimit të vazhdueshëm sistematik të të gjitha aktgjykimeve dhe aktvendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të gjitha këto vendime të publikuara nga Gjykatat e Kosovës gjatë kësaj periudhe janë monitoruar një nga një sa i përket përmbushjes së kërkesave që përcaktohen me aktet nënligjore në fuqi.

Ky raport ka për qëllim që të paraqes gjendjen faktike të publikimit të aktgjykimeve dhe aktvendimeve nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës, të identifikoj problemet dhe sfidat në publikimin e tyre, si dhe të ofroj një listë rekomandimesh për veprimet që organet gjyqësore duhet të ndërmarrin për të përmirësuar shkallën dhe cilësinë e publikimit të këtyre vendimeve.

Paraprakisht, të gjitha gjykatat janë informuar përmes postës elektronike se do të jenë subjekt i monitorimit për numrin dhe dinamikën e publikimit të vendimeve, si dhe nëse publikimi i vendimeve ndjek kërkesat e veçanta të ligjit, të udhëzimeve administrative dhe të vendimeve tjera relevante në fuqi. Të dhënat e mbledhura nga ky proces i monitorimit janë publikuar për çdo muaj në formë infografikash dhe janë publikuar në rrjetet sociale të Lëvizjes FOL.

Nga vendimet e publikuara në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Lëvizja FOL ka krijuar një databazë me të dhëna. Rrjedhimisht, vendimet e njejta të evidentuara gjatë kësaj periudhe nuk janë bashkangjitur në këtë databazë. Kjo databazë, ndër të tjera, përfshinë:

- numrin e përgjithshëm të aktgjykimeve dhe aktvendimeve të publikuara nga çdo gjykatë, për çdo muaj;
- nivelin e respektimit të protokolleve dhe afateve të parapara me aktet nënligjore për publikimin e vendimeve, si dhe pajtueshmëria e aktgjykimeve/aktvendimeve të publikuara me Ligjin për Gjykatat dhe udhëzimet administrative;
- mbrojtjen e të dhënave personale të palëve dhe specifikat tjera të cilat rregullohen me ligj dhe akte të tjera;
- gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime;
- nivelin e zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve;
- gjuhën në të cilën janë publikuar vendimet, si dhe
- llojin dhe natyrën e vendimeve të publikuara.

Për të nxjerrur një përqindje të saktë të publikimit të vendimeve nga gjykatat përkatëse, duhet të dijmë numrin e lëndëve që kanë marrur epilog gjyqësor gjatë periudhës së monitorimit. Prandaj, FOL ka krahasuar numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të publikuara në secilën gjykatë gjatë vitit 2022.

Numri i lëndëve të zgjidhura nga të gjitha gjykatat dhe degët e tyre është nxjerrur nga Raporti Statistikor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2022.²

Nga numri i lëndëve të zgjidhura për secilën gjykatë janë zbritur vendimet për kundërvajtje dhe vendimet për të mitur, vendime këto që sipas Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara, nuk do të duhej të publikoheshin në ueb faqen e KGJK-së. Kjo për të reflektuar sa më saktë përqindjen e lëndëve që janë publikuar në raport me ato të zgjidhura.

Rrjedhimisht, duke vlerësuar proporcionin në mes të lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara, Lëvizja FOL ka listuar tri gjykatat dhe tri degët me më së shumti aktgjykime të publikuara.

² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Departamenti i Statistikave, Raporti Statistikor Vjetor i Gjykatave për vitin 2022.

3. Baza ligjore e publikimit të vendimeve gjyqësore

Një parim themelor i një demokracie të shëndoshë është dialogu i hapur dhe transparenca. Dialogu i hapur në mes të gjykatave dhe qytetarëve do të thotë një dëgjim i hapur dhe një gjykim publik. Ky parim është mishëruar në Konventa dhe Marrëveshje Ndërkombëtare të cilat përmbajnë norma detyruese për të gjitha shtetet. Për të arritur këtë, sistemi gjyqësor duhet të ndërtojë mekanizma të cilët do të siguronin transparençën dhe do të ngrisin nivelin e besueshmërisë publike.

Parimi i gjykimit publik, pra gjykimit me dyer të hapura, është inkorporuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës³, ku në nenin 31 të saj parashihet se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut.

Për të përmbushur sa më mirë këtë mision, Ligji për Gjykatat (Nr. 06/L – 054)⁴ që u miratua në dhjetor të vitit 2018 dhe që është aktualisht në fuqi, ka bërë progres në rritjen e transparençës së gjyqësorit, duke e bërë të detyrueshme për të gjitha gjykatat publikimin e të gjitha vendimeve brenda 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në faqet e tyre të internetit.

Për të përmirësuar cilësinë e vendimeve dhe për t'u siguruar që ato t'i përmbajnë elementet thelbësore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2018 nxori *Vendimin për Standardizimin e Formave të Vendimeve* dhe krijoi grupin punues për krijimin e *Shabllonit për Standardizimin e Formave*. Në këtë shabllon janë paraqitur format e të gjitha vendimeve penale dhe civile dhe ndër të tjera kërkohet që në fillim të aktgjykimit të vendoset Emblema e Republikës së Kosovës, dhe që numri unik i lëndës të vendoset në anën e djathtë të tij etj. Gjithashtu kërkohet që publikimi i vendimeve të publikohet brenda afatit 60 ditë që nga dita e marrjes së vendimit.

Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë publikimit të vendimeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në fund të vitit 2019 ka nxjerrë *Udhëzimin e ri Administrativ për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara dhe Manualin për Publikimin dhe Përpunimin e Vendimeve*. Në fund të vitit 2021 ky udhëzim pësoj disa ndryshime. Përkatësisht, në dhjetor të vitit 2021, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë *Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021*⁵ për plotësimin dhe ndryshimin e *Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara*. Si një prej ndryshimeve esenciale të parapara në këtë ndryshim/plotësim, ishte se përveç vendimeve, gjykatat obligohen të publikojnë edhe aktvendimet meritore.

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 31

⁴ Ligji Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

⁵ https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/lgs/60388_Udhezim_Administrativ_Nr_01_2021_per_plotesimin_dhe_ndryshimin_Udhezimit_Administrativ_04_2019_per_publicimin_vendimeve_te_perpunuara.pdf

Gjatë vitit 2022, u shënuar një kthesë për lëndët ekonomike ku qytetarët tashmë kanë një derë se ku të drejtohen, pra u funksionalizua Gjykata Komerciale. Me krijimin e kësaj gjykate, ngarkesa e Gjykatës Themelore të Prishtinës lehtësohet dhe rritet efikasitetin në zgjidhjen e këtyre lëndëve.

Për këtë çështje, KGJK në fund të vitit 2022 miratoi edhe *Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara*⁶, ku obligon edhe Gjykatën Komerciale që të publikoj të gjitha vendimet, duke ju përmbajtur edhe kërkesave të tjera që rrjedhin nga aktet tjera.

Në Republikën e Shqipërisë çështja e publikimit të aktgjykimeve është e rregulluar me *Ligjin për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor (Nr.98/2016)* i Republikës së Shqipërisë, i cili e obligon secilën gjykatë që të publikojë të gjitha vendimet e parapara me ligj, mirëpo mangësi e këtij ligji është mos përcaktimi i një afati kohor rreth publikimit të këtyre vendimeve.


Kroacia si një shtet me një demokraci të zhvilluar, përmes platformës "E-Case" publikut i mundëson qasja në të dhënat bazë për çështjet gjyqësore, një shërbim pa pagesë për palët, avokatët dhe personat e tjerë të interesuar të përfshirë në procedurat gjyqësore. Kërkimi sipas gjykatës dhe numri i dosjes i mundëson vizitorit të informohet për ecurinë dhe dinamikën e zgjidhjes së lëndëve.⁷ Duke qenë se sistemi rifreskon të dhënat e rasteve në baza ditore, palëve u jepet akses në statusin aktual të çështjes së tyre.

Sa i përket Finlandës, ajo në faqen "FINLEX" ka të publikuara përmbledhjet e vendimeve të Gjykatave të Finlandës që nga viti 1944, në dy gjuhë, në atë finlandeze dhe suedeze. Këto përmbledhje janë të qasshme për të gjithë qytetarët e vendit dhe gjithashtu mund të shohin edhe përmbledhjet e vendimeve të Gjykatës së Lartë Administrative, të konsideruara me vlerë si precedentë, dhe që janë botuar në Librin vjetor të Gjykatës që nga viti 1918. Përafërsisht njëqind raste janë botuar në çdo vëllim të Librit Vjetar. Përmbledhjet shkruhen gjithmonë në gjuhën që është përdorur si gjuhë e procedurës në këtë çështje, d.m.th. në finlandisht ose suedisht.⁸

6 https://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/decisions/30130_Vendimi_KGJK_se_Nr_510_2022.pdf

7 <https://sudovi.hr/en/citizens/e-case>, Courts of Republic of Croatia.

8 <https://ëëë.kho.fi/en/index/decisions.html#>



Gjykata Supreme


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



4,551



3,188



FIGURA 1

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Supreme, duke përfshirë Kolegjin e Apelit dhe Dhomën e Posaçme, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 ka publikuar gjithsej 3,188 aktgjykime dhe aktvendime meritorë (në tekstin e mëtejshëm: vendime).⁹


Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2022, që gjatë kësaj periudhe ishin gjithsej 4,551 lëndë, kjo gjykatë ka arritur të publikoj 70% të vendimeve nga lëndët që gjatë këtij viti kishin marrur epilog gjyqësor.

Ky nivel i publikimit dëshmon rritje të theksuar në krahasim me vitin paraprak, ku Gjykata Supreme kishte publikuar gjithsej 2,232 vendime, përkatësisht 42% më shumë.

Në figurën e mëposhtëm është pasqyruar niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar – dhjetor 2022.

⁹ Gjatë monitorimit të vendimeve në uen-faqen e KGJK-së janë evidentuar edhe 31 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.


FIGURA 2 Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 në Gjykatën Supreme.



Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme gjatë kësaj periudhe ka publikuar 2,016 vendime nga 2903 lëndë të zgjidhura gjithsej gjatë kësaj periudhe. Pra *Dhoma e Posaçme* ka publikuar 69 % të vendimeve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe. Ndërsa *Kolegji i Apelit* ka publikuar vetëm 3 vendime.¹⁰

Publikimi i vendimeve nga *Dhoma e Posaçme* dhe *Kolegji i Apelit* për çdo muaj kalendarik gjatë vitit 2022 në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme.


FIGURA 3 Niveli i publikimit të vendimeve nga *Dhoma e Posaçme* dhe *Kolegji i Apelit* gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



¹⁰ Numri i lëndëve të zgjidhura nga Kolegji i Apelit nuk është paraqitur në Raportin Statistikor të KGJK-së.

Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë janë të natyrës civile, respektivisht 2,013 vendime civile, 553 prej tyre janë të natyrës penale, 502 vendime të natyrës administrative dhe 120 vendime për çështje ekonomike.

Në grafikën në vijim është paraqitur ndarja e vendimeve të publikuara nga Gjykata Supreme, sipas llojit të lëndëve.




Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, gjatë kësaj periudhe të monitorimit Gjykata Supreme ka publikuar 7 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit, si dhe vetëm një ak-
tgjykim të dhunës në familje.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, 2,999 apo 94% prej tyre janë pu-
blikuar në gjuhën shqipe, ndërsa 189 vendime apo 6 % prej tyre janë publikuar në gjuhën serbe.
Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet nga kjo gjykatë është paraqitur në mënyrë grafike në
figurën e mëposhtme.



Kërkesat e përcaktuara në *Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve* nga kjo gjykatë janë zbatuar në nivel të kënaqshëm. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, në 2,940 vendime është zbatuar ky vendim, apo në 92% ndërsa në pjesën tjetër prej 248 vendimesh apo 8% janë evidentuar lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme është shprehur në mënyrë grafike zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Supreme.



Ndërkaq *Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara* nuk është zbatuar në përpikmëri në të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë. Nga 3,188 aktykime të publikuara për periudhën janar- dhjetor 2022, të dhënat personale që janë fshehur me përpikmëri janë 3,109 vendime ndërsa 169 prej tyre janë të pa anonimizuara.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Supreme është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **38 ditë** për t'i publikuar vendimet.

Lëvizja FOL, gjithashtu ka monitoruar se cilët gjyqtarë kanë publikuar më shumë vendime gjatë periudhës janar-dhjetor 2022. Nga ky monitorim kemi listuar nga 3 gjyqtarë të secilës gjykatë që kanë prirë me publikim të vendimeve.

Tre gjyqtarët që kanë publikuar më shumë vendime në Gjykatën Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 7

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Supreme me më së shumti vendime të publikuara janë: Gazmend Sylaj me 284 vendime të publikuara, Sahit Sylejmani me 255 vendime të publikuara, si dhe Shkelzen Sylaj me 234 vendime të publikuara.




Gjykata e Apelit


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



15,013



7,451



FIGURA 7

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.


Gjykata e Apelit, duke përfshirë Divizionin e Apelit të Mitrovicës, gjatë periudhës janar - dhjetor 2022 ka publikuar gjithsej 7,451 vendime.¹¹

Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe ka zgjidhur gjithsej 15,013 lëndë (duke i përjashtuar lëndët për të mitur dhe kundërvajtjet), dhe rrjedhimisht nga të dhënat e monitorimit del se janë publikuar rreth 50 % të vendimeve nga lëndët që kishin marrur epilog gjyqësor gjatë këtij viti.

Në krahasim me vitin e kaluar, ku Gjykata e Apelit kishte publikuar 3,069 vendime, këtë vit kishte shënuar rritje të publikimit prej 41% më shumë. Nëse nuk merret parasysh numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe, me këtë nivel të publikimit të vendimeve, kjo gjykatë renditet në vendin e parë për nga numri i publikimeve.


Në figurën e mëposhtëm është paraqitur niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar – dhjetor 2022.

¹¹ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 38 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

FIGURA 8 Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 në Gjykatën e Apelit.

Divizioni i Apelit të Mitrovicës, si pjesë e kësaj gjykate, në këtë vit ka publikuar gjithsej 126 vendime¹², vendime këto të publikuara vetëm gjatë muajit qershor dhe korrik.

Në tabelën e mëposhtme është shprehur në mënyrë grafike niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Divizioni i Apelit të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

FIGURA 9 Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 në Divizionin e Apelit të Mitrovicës.

¹² Numri i lëndëve të zgjidhura nga Divizioni i Apelit të Mitrovicës nuk është paraqitur në Raportin Statistikor të KGJK-së.


Sa i përket natyrës së lëndëve, edhe Gjykata e Apelit ka publikuar më shumë vendime të natyrës civile. Nga totali i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 4,095 prej tyre janë të natyrës civile, 1,154 sosh të natyrës penale, 825 të natyrës administrative, ndërsa vendime për çështje ekonomike 1,377.

Në tabelën e mëposhtme është përshkruar publikimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit, të ndarë sipas llojit të lëndëve.




Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 30 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit, ndërsa 10 vendime të dhunës në familje.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, Gjykata e Apelit ka publikuar 7,152 apo 97% të vendimeve në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën serbe 229 aktgjykimve apo 3%. Gjuha e publikimit të aktgjykimëve në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga kjo gjykatë është arritur në nivel të kënaqshëm. Në pjesën prej 6,320 vendimesh vendimi është zbatuar në përpikmëri, ndërsa në 1,131 vendime ky vendim nuk është zbatuar në mënyrën e përcaktuar në këtë vendim.

Në figurën në vijim është paraqitur niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikara nga Gjykata e Apelit.



Sa i përket respektimit të Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Aktgjykiemeve të Përpunuara, Gjykata e Apelit nga 7,451 vendime, 80 prej tyre i ka publikuar pa u`a fshehur të dhënat personale subjekteve që kërkohet me këtë udhëzim.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës së Apelit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **140 ditë** për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon dyfish kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve, i cili shprehimisht përcakton se Vendimet gjyqësore duhet të publikohen brenda 60 ditëve nga marrja e vendimit të formës së prerë.

Ndërkaq gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 13

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit me më së shumti vendime të publikuara janë: Mahir Tutuli me 770 vendime të publikuara, Liridon Maloku me 639 vendime të publikuara si dhe Lumni Sallauka me 398 vendime të publikuara.



Gjykata Komercciale




FIGURA 14


Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Komercciale gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Komercciale, si një gjykatë e re e themeluar në gusht të vitit të kaluar, ka arritur të publikoj 422 vendimet e saj të para në muajin dhjetor të vitit 2022.

Rrjedhimisht, që nga muaji gusht kur është funksionalizuar, Gjykata Komercciale ka arritur të zgjidhë 1,038 lëndë, ndërsa në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura rezulton se Gjykata Komercciale ka arritur të publikoj 40 % të vendimeve nga lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Dhoma e Shkallës së Parë së kësaj gjykate gjatë kësaj periudhe ka publikuar 197 vendime nga 605 lëndë të zgjidhura (32 %), ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë ka publikuar 227 vendime nga 434 lëndë të zgjidhura (52%).

Të gjitha vendimet e Gjykatës Komercciale kanë qenë të publikuara në gjuhën shqipe. Gjuha e vendimeve të publikuara është paraqitur edhe në grafikën e mëposhtme.



Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në mënyrë të kënaqshme nga kjo gjykatë, për shkak se vetëm 1 vendim është evidentuar jashtë rregullave që i parasheh ky vendim.

Më poshtë shihni grafiken se si ka përfomuar Gjykata Komeriale sa i përket Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve gjatë kësaj periudhe.



Sa i përket anonimizimit, nga 422 vendime të publikuara nga kjo gjykatë, 105 prej tyre janë të pa anonimizuara.¹³

¹³ Lëshime në këtë gjykatë janë gjetur në fshehjen e të dhënave të përfaqësuesve të palëve.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Komeriale është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **71 ditë** për ti publikuar vendimet.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Komeriale janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.

FIGURA 17

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Komeriale gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Komeriale me më së shumti vendime të publikuara janë: Faton Bajrami me 70 vendime të publikuara, Krenar Berisha me 66 vendime të publikuara, si dhe Verona Dibrani me 55 vendime të publikuara.



Gjykata Themelore e Prishtinës

Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara




FIGURA 18

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Themelore e Prishtinës, duke përfshirë 4 degët e saj (Dega në Podujevë, Dega në Graçanicë, Dega në Lipjan dhe Dega në Glogoc), gjatë kësaj periudhe ka publikuar 5,784 vendime.¹⁴

Gjykata Themelore e Prishtinës (si dhe degët e saj) gjatë vitit 2022 kishte zgjidhur 23,580 lëndë, dhe rrjedhimisht nga të dhënat e monitorimit rezulton se kjo gjykatë ka publikuar vetëm rreth 25 % të vendimeve të nxjerrura nga lëndët që gjatë këtij viti kishin marrur epilog gjyqësor.


¹⁴ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 174 vendime të tjera të përsëritura dhe procesverbale, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Në vitin paraprak (2021), Gjykata Themelore e Prishtinës ka qenë gjykata me numrin më të madh të vendimeve të publikuara, edhe pse këtë vit ka publikuar 191 vendime më shumë se vitin e kaluar. Ndërsa sa i përket vitit 2022, nëse përjashtohet numri i lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti, kjo është gjykata e dytë me më së shumti vendime të publikuara, menjëherë pas Gjykatës së Apelit.

Në grafikën në vijim janë paraqitur të dhënat mbi numrin e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar – dhjetor 2022.

FIGURA 19

Niveli i publikimit të vendimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Në këtë numër të madh të publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë, në masë të madhe kanë kontribuar edhe degët e kësaj gjykate. Të gjitha degët e kësaj gjykate në tërësi kanë publikuar 1,825 vendime, përkatësisht 31% të vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë si tërësi.

Dega e Glllogocit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 850 vendime nga 1,938 lëndë të zgjidhura (44%), Dega e Lipjanit ka publikuar 772 vendime nga 2,209 lëndë të zgjidhura (38 %), Dega e Podujevës 202 vendime nga 2,648 lëndë të zgjidhura (8%), ndërsa Dega e Graçanicës ka publikuar vetëm 1 aktgjykim nga 627 lëndë të zgjidhura (0.2 %).

Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, Dega e Podujevës ka dukshëm më pak vendime të publikuara për këtë vit, përkatësisht 357 vendime më pak. Gjithashtu edhe Dega e Graçanicës në vitin e kaluar kishte 76 vendime, ndërsa këtë vit vetëm 1 vendim.

Shifrat e publikimit të degëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë në mënyrë grafike janë paraqitur edhe në figurën në vijim.




FIGURA 20

Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar - dhjetor 2022.


Ndërkaq sa i përket natyrës së vendimeve të publikuara, edhe Gjykata Themelore e Prishtinës ashtu si Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit, prinë me publikimin e vendimeve të natyrës civile. Respektivisht, nga numri i përgjithshëm i publikimit, 2,272 vendime janë të natyrës civile, 1,247 të natyrës penale, 701 prej tyre administrative dhe 1,564 vendime për çështje ekonomike.

Ky klasifikim i vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës është pasqyruar edhe në grafikën e mëposhtme.



Nga vendimet penale, 17 vendime janë për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, ndërsa 60 vendime të dhunës në familje. Mund të themi se kemi ulje të publikimit të vendimeve të natyrës me dhunë në bazë gjinore nga viti i kaluar sepse në vitin e kaluar ishin rreth 278 vendime të publikuarat ë dhunës në familje.


Gjykata Themelore në Prishtinë ka publikuar 1 aktgjykim në gjuhën serbe, ndërsa pjesa tjetër e vendimeve janë publikuar në gjuhën shqipe. Në mënyrë grafike, gjuha e publikimit të aktgjykimeve është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.



Vendimi për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në masë të konsiderueshme nga kjo gjykatë. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, ky vendim është zbatuar në 4,749 vendime, ndërsa në 1,035 vendime të tjera janë vërejtur lëshime në zbatimin e tij. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike zbatimi i këtij akti në vendimet e publikuara të kësaj gjykate.

FIGURA 23

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Ndërkaq sa i përket fshehjes së të dhënave personale, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 304 vendime janë publikuar të pa-anonimizuara.¹⁵

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **217 ditë** për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se edhe gjykata e kalon dukshëm kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve. Në vitin e kaluar Gjykatës Themelore të Prishtinës i janë dashur 100 ditë kohë për t'i publikuar vendimet.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë paraqitur në grafikonin në vijim.

FIGURA 24

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prishtinës me më së shumti vendime të publikuara janë: Rexhep Gashi me 312 vendime të publikuara, Adnan Konushevcu me 293 vendime të publikuara si dhe Bajram Miftari a me 257 vendime të publikuara.

¹⁵ Më së shumti lëshime në këtë gjykatë janë evidentuar në fshehjen të dhënave personale të të paditurve, dëshmitarëve, si dhe të tabelave të regjistrimit të automjeteve.



Gjykata Themelore e Mitrovicës


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



7,271



3,254



FIGURA 25

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar - dhjetor 2022.

Gjykata Themelore e Mitrovicës, duke përfshirë katër degët e saj (Skenderajin, Vushtrrinë, Leposaviqin dhe Zubin Potokun) gjatë periudhës janar - dhjetor 2022 në ueb-faqe kanë publikuar gjithsej 3,254 vendime.¹⁶

Rrjedhimisht, në krahasim me numrin e lëndëve të zgjidhura nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë vitit 2022, numër ky që gjatë kësaj periudhe ishte 7,271 lëndë, rezulton se kjo gjykatë (përfshirë degët e saj) ka publikuar 45% të vendimeve nga lëndët e zgjidhura.


Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura, kjo është gjykata e dytë themelorë me më së shumti vendime të publikuara gjatë kësaj periudhe. Krahasuar me vitin e 2021, kjo gjykatë këtë vit ka publikuar 200 vendime më shumë.

Publikimi i vendimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për secilin muaj, në mënyrë grafike është shfaqur në figurën e mëposhtme.

¹⁶ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 11 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

FIGURA 26

Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë, apo 1,904 vendime (59 % e vendimeve), janë publikuar nga degat e kësaj gjykate.

Dega e Vushtrrisë ka publikuar 1,332 vendime nga 2,708 lëndë të zgjidhura (49 %), Dega e Skenderajt ka publikuar 432 vendime nga 1,336 lëndë të zgjidhura (32 %), Dega e Leposaviqit ka publikuar 101 vendime nga 202 lëndë të zgjidhura (43%), ndërsa Dega e Zubin Potokut 39 vendime nga 139 lëndë të zgjidhura (28 %).

Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë është shfaqur grafikisht në tabelën e mëposhtme.





FIGURA 27 Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara janë të natyrës penale, përkatësisht 1,645 vendime penale, ndërsa 1,609 vendime janë të natyrës civile. Në grafikën në vijim është paraqitur ndarja e vendimeve të publikuara nga Gjyakta Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 sipas natyrës së veprës.



Nga vendimet penale, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhë ka publikuar 5 vendime të korrupsionit dhe 72 vendime të dhunës në familje.

Nga të gjitha vendimet e publikuara, 2,427 vendime janë publikuar në gjuhën shqipe (75%), ndërsa 827 vendime të tjera janë publikuar në gjuhën serbe (25 %).




Sa i përket anonimizimit të vendimeve, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe ka publikuar 152 vendime pa fshehjen e të dhënave personale.¹⁷

Sa i përket zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve, nga të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë dhe degët e saj, lëshime janë gjetur në 363 vendime. Ndërsa në pjesën tjetër prej 2,942 vendimesh, ky vendim është zbatuar me korrektësi.

Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë grafike është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.

FIGURA 30

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **50 ditë** për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se Gjykata Themelore e Mitrovicës sa i përket kohës së publikimit të vendimeve e respekton plotësisht kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë kësaj periudhe në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

¹⁷ Më së shumti lëshime në këtë gjykatë janë vërejtur në fshehjen e emrit, mbiemrit dhe të numrave personal të palëve.

FIGURA 31

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës me më së shumti vendime të publikuara janë: Agron Maxhuni me 279 vendime të publikuara, Ferki Xhaferi me 186 vendime të publikuara, si dhe Gezim Ademi me 167 vendime të publikuara.



Gjykata Themelore e Pejës

Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara




FIGURA 32

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Themelore e Pejës, duke përfshirë tri degët e saj (Deçanin, Istogun dhe Klinën) gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 ka publikuar 1,660 vendime.


Rrjedhimisht, në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura, numër ky që gjatë vitit 2022 ishte 9,082 lëndë, rezulton se janë publikuar vetëm 18 % e vendimeve nga lëndët e zgjidhura. Me këto shifra, kjo gjykatë renditet e fundit sa i përket publikimit të vendimeve gjatë kësaj periudhe.

Kjo gjykatë është e vetmja që ka shënuar ulje të publikimit në krahasim me vitin 2021, për shkak në vitin paraprak kjo gjykatë kishte publikuar 2,189 vendime (pra 24 % më pak vendime të publikuara gjatë këtij viti).

Pjesën më të madhe të vendimeve kjo gjykatë i ka publikuar gjatë muajit maj, përkatësisht 373 vendime. Ndërsa më së paku vendime i ka publikuar në muajin mars, përkatësisht 19 vendime.

Publikimi i vendimeve nga kjo gjykatë gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është pasqyruar në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 33 Numri i vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pjesa më e madhe e vendimeve të kësaj gjykate, apo 1,223 vendime (74 %), janë publikuar nga degët e kësaj gjykate.

Dega e Deçanit gjatë kësaj periudhe kishte publikuar 268 vendime, nga 1,291 lëndë të zgjidhura (21%) *Dega e Istogut* 693 vendime nga 1,871 lëndë të zgjidhura (37%), ndërsa *Dega e Klinës* 272 vendime nga 1176 lëndë të zgjidhura (23%). Niveli i publikimit të degëve të Gjykatës Themelore të Pejës për çdo muaj gjatë kësaj periudhe është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 34


Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 531 vendime janë të natyrës penale, ndërsa 1,342 sosh janë të natyrës civile. Natyra e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë është përshkruar edhe në grafikën e mëposhtme.



Nga të gjitha vendimet e publikuara, ne kemi evidentuar vetëm 5 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe vetëm 24 vendime të dhunës në familje.

Kjo gjykatë nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe, njëjtë sikurse në vitin paraprak. Kjo është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.




Gjatë monitorimit, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë, ne kemi evidentuar 19 vendime të pa-anonimizuara.

Zbatimi i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjytimeve është arritur në shumicën e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë gjetur në 23 vendime të publikuara. Në tabelën e mëposhtme është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 37

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Pejës.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Pejës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **49 ditë** për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e ka respektuar në përpikmëri kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 nga Gjykata Themelore e Pejës.

FIGURA 38

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 në Gjykatën Themelore të Pejës.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Pejës me më së shumti vendime të publikuara janë: Blerim Istrefi me 306 vendime të publikuara, Shemsedin Haxhijaj me 205 vendime të publikuara, si dhe Bekim Avdimetaj me 203 vendime të publikuara.



Gjykata Themelore e Prizrenit

Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara




FIGURA 39

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Themelore e Prizrenit, duke përfshirë Degën e Suharekës dhe atë të Dragashit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 kjo gjykatë ka publikuar gjithsej 3,011 vendime¹⁸, dhe renditet në vendin e gjashtë për nga numri i publikimit të vendimeve.


Gjatë kësaj periudhe kjo gjykate kishte zgjidhur gjithsej 13,318 lëndëve, dhe rrjedhimisht nga të dhënat e monitorimit rezulton se kjo gjykatë ka publikuar vetëm 22 % të vendimeve nga lëndët që gjatë kësaj periudhe kishin marrur epilog gjyqësor.

¹⁸ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë është evidentuar 1 vendim i përsëritur, që nuk është përfshirë në këto shifra.

Pra, në krahasim me vitin paraprak kur kjo gjykatë kishte publikuar 2,280 vendime, në këtë vit ky numër ishte rritur për 32% më shumë.

Në tabelën në vijim, në mënyrë grafike është pasqyruar shkalla e publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 40 Niveli i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Kontribut të madh në rritjen e publikimit të vendimeve në kuadër të kësaj gjykate kanë pasur edhe dy degët e saj. Gjatë kësaj periudhe ato kanë publikuar 1904 aktgjykime, përkatësisht 63% të aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë.

Dega e Suharekës kishte publikuar 540 vendime nga 2,962 lëndë të zgjidhura (18%), ndërsa Dega e Dragashit në ueb- faqe ka publikuar gjithsej 147 vendime nga 559 lëndë të zgjidhura (26 %).

Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit është shfaqur në mënyrë grafike për secilin muaj në tabelën e mëposhtme.




	 Dragash	 Suharekë
Janar	2	83
Shkurt	20	2
Mars	0	73
Prill	17	73
Maj	26	40
Qershor	31	55
Korrik	0	47
Gusht	14	33
Shtator	13	48
Tetor	10	74
Nëntor	11	12
Dhjetor	3	0

FIGURA 41


Niveli i publikimit të vendimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Sa i përket natyrës së vendimeve të publikuara, kjo gjykatë prinë me publikimin e vendimeve penale, me 1,638 sosh, ndërsa civile 1,373 vendime. Klasifikimi i vendimeve sipas llojit të tyre është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.



Nga aktgjykimet penale të publikuara, vetëm 4 prej tyre kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit, 124 me dhunë në familje. Gjykata Themelore e Prizrenit renditet e para për nga numri i publikimit të aktgjykimëve të dhunës në familje.

Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, duhet të theksohet se gjatë kësaj periudhe nga 3,011 vendime të publikuara vetëm 1 vendim është publikuar në gjuhën serbe. Pra, të gjitha vendimet tjera të Gjykatës Themelore të Prizrenit kanë qenë vetëm në gjuhën shqipe.




Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale kjo gjykatë ka treguar kujdes të veçantë në krahasim me vitin e kaluar. Në këtë vit kjo gjykatë është përmirësuar dhe se nga të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë, vetëm 43 prej tyre janë me lëshime. Kryesisht lëshime janë bërë në të dhënat personale të të akuzuarve, përfaqësuesit e palës, vendbanimi i palëve, dëshmitarët.

Nga të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë, lëshime në zbatimin e Vendimit të Këshillit Gjyqësor për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve janë vërejtur në 329 vendime. Ndërkaq në pjesën tjetër prej 2,682 vendimesh, shablloni është zbatuar në përpikmëri. Në grafikonin e mëposhtëm është përshkruar niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit, për çdo muaj.

FIGURA 44

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **66 ditë** për t'i publikuar vendimet.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatë Themelore të Prizrenit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 45

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit me më së shumti vendime të publikuara janë: Fatmir Krasniqi me 212 vendime të publikuara, Qemajl Suka me 211 vendime të publikuara, si dhe Refki Piraj me 181 vendime të publikuara.



Gjykata Themelore e Ferizajt

Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



6,282



2,875



FIGURA 46

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën e Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Themelore e Ferizajt, duke përfshirë Degën e Kaçanikut dhe atë të Shtërpçës, gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 ka publikuar 2,875 vendime.¹⁹

Rrjedhimisht, prej 6,282 lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2022 nga kjo gjykatë, nga të dhënat e monitorimit rrjedh se gjatë këtij viti janë publikuar rreth 46 % të vendimeve nga lëndët që këtë vit kishin marrur epilog gjyqësor.

Me këto shifra, kjo gjykatë renditet e para nga rradhët e gjykatave të shkallës së parë sa i përket publikimit të aktgjyqimeve në raport me lëndët e zgjidhura.


¹⁹ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 47 vendime të tjera të përsëritura dhe procesverbale, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Publikimi i vendimeve nga kjo gjykatë është rritur për 14 % krahasuar me vitin paraprak kur kjo gjykatë kishte publikuar 2,509 vendime.

Në figurën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike publikimi i vendimeve për çdo muaj nga kjo gjykatë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

FIGURA 47

Niveli i publikimit të vendimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Edhe degët e kësaj gjykate kanë publikuar numër relativisht të madh të vendimeve, duke publikuar rreth 25 % të vendimeve të kësaj gjykate.

Dega e Kaçanikut gjatë kësaj periudhe ka publikuar 601 vendime nga 974 lëndë të zgjidhura (61 %), duke shënuar kështu degën me numrin më të madh të vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe në raport me lëndët e zgjidhura. Ndërsa Dega e Shtërpcës ka publikuar 127 vendime nga gjithsej 520 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (24 %).

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është shfaqur publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt, për çdo muaj.




	 Kaçanik	 Shtërpçë
Janar	61	3
Shkurt	43	12
Mars	58	8
Prill	42	0
Maj	50	1
Qershor	59	34
Korrik	62	20
Gusht	0	9
Shtator	86	12
Tetor	75	8
Nëntor	65	17
Dhjetor	0	3

FIGURA 48 Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.


Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar më shumë aktgjykime të natyrës penale, se sa civile. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, 1,462 aktgjykime janë të natyrës penale, ndërsa 1,413 të natyrës civile.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur ndarja e vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore e Ferizajt, sipas llojit të tyre.



Nga të gjitha vendimet penale të publikuara nga kjo gjykatë, 7 prej tyre janë për veprat penale të korrupsionit, 46 vendime të dhunës në familje.


Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar këto vendime, kjo gjykatë gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 ka publikuar 2,726 në gjuhën shqipe ndërsa aktgjykimet tjera në gjuhën serbe.



Gjatë kësaj periudhe, ky vendim është zbatuar në 2,220 vendime apo 77% nga totali i përgjithshëm, ndërsa në pjesën tjetër prej 655 apo 23% vendimesh, është vërejtur lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet zbatimi i Vendimit për Standardizmin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

FIGURA 51 Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.



Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, Gjykata Themelore e Ferizajt ka publikuar vetëm 34 vendime pa fshehjen e të dhënave personale, ndërsa vendimet tjera kanë qenë të anonimizuara në tërësi.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Ferizajt është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **36 ditë** për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë vendimet i publikon brenda kohës së paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre. Krahasuar me vitin e kaluar kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 53 ditë kohë dhe se në këtë vit ky numër është zvogluar dukshëm.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

FIGURA 52 Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Ferizajt me më së shumti vendime të publikuara janë: *Faton Ajvazi* me 586 vendime të publikuara, *Zajrete Muhaxheri* me 198 vendime të publikuara, si dhe *Burim Çaka* me 189 vendime të publikuara.




Gjykata Themelore e Gjilanit


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



8,421



3,744



FIGURA 53

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Themelore e Gjilanit, duke përfshirë tri degët e saj (Degën e Kamenicës, Vitisë dhe të Novobërdës) gjatë kësaj periudhe ka publikuar gjithsej 3,744 vendime.²⁰


Rrjedhimisht, nga 8,421 lëndë të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2022, rezulton se kjo gjykatë ka arritur të publikoj 44 % të vendimeve nga lëndët të cilat gjatë kësaj periudhe kishin marrur epilog gjyqësor.

²⁰ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 175 vendime të tjera të përsëritura dhe procesverbale, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Kjo se ky nivel i publikimit të aktgjykimeve gjatë këtij viti është trefishuar në raport me vitin 2021 ,kur kjo gjykatë kishte publikuar 1,221 vendime.

Niveli i publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë për secilin muaj, është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 54 Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Duhet të theksohet se degët e Gjykatës Themelore të Gjilanit kanë filluar të aktivizohen sa i përket publikimit të vendimeve në këtë periudhë të monitorimit, duke zënë 28 % të aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë në tërësi.

Dega e Vitisë gjatë kësaj periudhe ka publikuar 470 vendime nga 1,885 lëndë të zgjidhura (25%), *Dega e Kamenicës* ka publikuar 347 vendime nga 1,073 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (32%), ndërsa *Dega e Novobërdës* ka publikuar 240 vendime nga 504 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (48 %)

Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e kësaj gjykate për çdo muaj është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.





	 Viti	 Kamenicë	 Novobërdë
Janar	0	6	0
Shkurt	14	11	0
Mars	0	15	14
Prill	88	5	8
Maj	9	38	4
Qershor	81	71	45
Korrik	69	62	34
Gusht	0	10	22
Shtator	34	21	37
Tetor	28	21	18
Nëntor	59	46	44
Dhjetor	88	41	14

FIGURA 55 Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjilanit.

Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë, apo 2,594 vendime, janë të natyrës civile. Ndërsa pjesa tjetër prej 1,150 vendimesh janë të natyrës penale. Kjo ndarje e vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga kjo gjykatë mund të shihet edhe në grafikën e mëposhtme.



Nga të gjitha lëndët e natyrës penale të publikuara në ueb-faqen e KGJK-së, FOL ka evidentuar 13 vendime të korrupsionit, 48 vendime të dhunës në familje.

Nga të gjitha vendimet e publikuara gjatë kësaj periudhe, 344 prej tyre janë të publikuara në gjuhën serbe, ndërsa pjesa tjetër në gjuhën shqipe.




Gjatë monitorimit, janë evidentuar 158 vendime të pa anonimizuar²¹. Ndërkaq sa i përket Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga kjo gjykatë, FOL ka evidentuar 491 vendime në të cilat ka pasur lëshime në zbatimin e këtij vendimi. Niveli i zbatimit të këtij vendimi në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

21 Lëshime në fshehjen e të dhënave në këtë gjykatë janë evidentuar në fshehjen e vendbanimit të palëve dhe të dhënave të dëshmitarëve.

FIGURA 58

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Gjilanit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **80 ditë** për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon në kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve. Sa i përket vitit të kaluar kësaj gjykate i janë dashur 75 ditë për t'i publikuar vendimet.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Gjilanit me më së shumti vendime të publikuara janë: Besnik Pireva me 266 vendime të publikuara, Berat Spahiu me 238 vendime të publikuara, si dhe Alush Sinani me 204 vendime të publikuara.

FIGURA 59

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.





Gjykata Themelore e Gjakovës


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



8,600



3,305



FIGURA 60

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

Gjykata Themelore e Gjakovës, duke përfshirë Degën e Rahovecit dhe atë të Malishevës, gjatë kësaj periudhe në ueb-faqen zyrtare ka publikuar gjithsej 3,305 vendime.²²

Rrjedhimisht, nga 8,600 lëndë të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2022, nga të dhënat e monitorimit rezulton se kjo gjykatë ka arritur të publikoj rreth 38% të vendimeve nga lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe.


²² Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 3 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Ky numër i publikimit gjatë kësaj periudhe është rritur dukshëm, përkatësisht 46 %, në krahasim me vitin paraprak (2021), ku kjo gjykatë kishte publikuar 2,246 vendime.

Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Gjakovës për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 61

Niveli i publikimit të vendimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Gjakovës, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Edhe degët e kësaj gjykate kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e publikimit të vendimeve në kuadër të kësaj gjykate, duke publikuar gjithsej 1,418 vendime, apo 64% të të gjitha vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë.

Gjatë kësaj periudhe, *Dega e Malishevës* ka publikuar 565 vendime nga 1067 lëndë të zgjidhura (53%), ndërsa *Dega e Rahovecit* ka publikuar 853 vendime nga 1493 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (57%).

Me këto shifra, këto degë hyjnë në rradhën e degëve me më së shumti vendime të publikuara në raport me lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është pasqyruar publikimi i vendimeve të degëve të Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë kësaj periudhe.





FIGURA 62

Niveli i publikimit të vendimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.


Sa i përket llojit të vendimeve të publikuara, numër shumëfish më i madh i tyre janë të natyrës civile, respektivisht 2,138 vendime të kësaj natyre, ndërsa 1,137 vendime janë të natyrës penale.

Kjo ndarje e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës është paraqitur edhe në grafikonin e mëposhtëm.



Nga vendimet penale, gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar 6 aktgjykime në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe 72 aktgjykime në lidhje me veprat penale të dhunës në familje.

Gjykata Themelore të Gjakovës të gjitha vendimet i ka publikuar në gjuhën shqipe.




Sa i përket anonimizimit të vendimeve nga kjo gjykatë, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 289 vendime të pa anonimizuara dhe gabimet më të shprehura kanë qenë mos fshehja e të dhënave të përfaqësuesve të palës.

Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve nuk është zbatuar sa duhet nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë evidentuar në 363 vendime të publikuara. Zbatimi i këtij vendimi nga kjo gjykatë është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 65

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Gjakovës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht **44 ditë** për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se edhe kjo gjykatë i ka publikuar aktgjykimet brenda afatit të paraparë me ligj.

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.

FIGURA 66

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.



Pra nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Gjakovës me më së shumti vendime të publikuara janë: Durim Balaj me 510 vendime të publikuara, Betim Behluli me 367 vendime të publikuara, si dhe Mirjeta Shala me 338 vendime të publikuara.

Rekomandime

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti monitorues, rekomandimet në vijim shihen si të domosdoshme për përmirësimin e ngecjeve të evidentuara në këtë fushë. Këto rekomandime janë:

- Të monitorohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës niveli i zbatimit të të gjitha rregulloreve dhe vendimeve të KGJK-së, duke përfshirë edhe Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve.
- Të mos publikohen aktgjykime të njejta.
- Të përditësohet ueb-faqja e KGJK-së me lajme dhe njoftime të reja, të rëndësishme për publikun, duke përfshirë këtu edhe raportet statistikore në lidhje me vendimet e publikuara për çdo muaj.
- Të shmanget publikimi i vendimeve nga kontestet martesore, vendimet ku përfshihen të miturit, si dhe llojet e tjera të vendimeve që përjashtohen nga publikimi, të parapara në Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.
- Të rritet numri i zyrtarëve për informim në gjykatat me fluks të madh të lëndëve.
- Çdo aktgjykim para publikimit duhet të rishikohet nga zyrtarët për informim sa i përket harmonizimit të aktgjykimit me Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara si dhe nëse është arritur mbrojtja e të dhënave personale në tërësi.
- Të rritet publikimi i aktgjykimeve të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar.
- Vendimet të publikohen me kohë në ueb-faqen e KGJK-së, e jo të publikohen tërësisht në ditën e fundit të muajit.
- Të respektohet afati prej 60 ditësh për publikimin e aktgjykimeve, i paraparë në Ligjin për Gjykatat në lidhje me publikimin e tyre.
- Secila lëndë ta ketë numrin unik të lëndës.
- Të gjitha vendimet të publikohen në formatin PDF, siç kërkohet në Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

Burimet:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prill, 2008.
- Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Tetor, 2013.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr. 06/L-054) për Gjykatat, Dhjetor, 2018.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr.04/L-032) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat.
- Ligji Nr. 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Vendimeve të Plotëfuqishme, Shkurt 2016.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (04/2019) për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara, Dhjetor, 2019.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Shabllonet Standarde të Vendimeve – Vëllimi 1, 2018.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Statistikor i Gjykatave 2022

FOL

